



*Kuvendi i Komunës Klinë*

01Nr. 06-24286 /2026

Datë: 05, 08 /2026

*Duke u mbështetur në nenin 40, paragrafët 40.1 dhe 40.2, shkronja l), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 40, paragrafi 2, pika 11 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 15 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 të MPB-së dhe Nr. 03/2012 të MAPL-së për Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi, bazuar në kërkesën për zëvendësimin e anëtarit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, me nr. 01/06-21240/2026, të datës 15.07.2026, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e VII-të të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më 31.07.2026, mori këtë:*

**V E N D I M**

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për zëvendësimin e 2 (dy) anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Zëvendësimi bëhet si në vijim:

1.1. Largohet përfaqësuesi i Kishës Protestante, z. Jeton Sokoli, dhe i njëjti zëvendësohet me përfaqësuesen e kësaj kishe, znj. Drita Sokoli.

1.2. Largohet përfaqësuesi i Sektorit të Emergjencave Civile, z. Elmi Zenunaj, dhe i njëjti zëvendësohet me përfaqësuesin e këtij sektori, z. Rasim Elezaj.

2. Zëvendësimi bëhet pas kërkesës së parashtruar nga përfaqësuesit e lartcekur dhe me propozimin e kryesuesit të KKS-së, Kryetar të Komunës z. Zenun Elezaj.

3. Ky vendim është pjesë e Vendimit me nr. 01/06-9256/2026, të datës 27.03.2026, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

4. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi, bazuar në Ligjin Nr. 08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

*Me këtë vendim njoftohen:*

- MAPL;
- Kryetari i Komunës;
- Anëtarët e emëruar të KKS-së;
- Zyra për Informim;
- Arkivi i Komunës së Klinës.

